

AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORTI VJETOR
2020

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	3
1. Zbatimi i Rekomandimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut	4
2. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit	6
2.1. Përditësimi dhe Vlerësimi Financiar i Vendimeve përfundimtare	6
2.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare	7
2.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)	10
2.4. Për procesin e tjetërsimit të sipërfaqeve të shtetërore (oborreve në përdorim).....	10
3. Trajtimi i numrit të kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara	11
3.1. Dorëzimi i kërkesave të patrajtuara për njohje pronësie tek subjektet dhe inventarizimi i tyre në arkiv.	11
3.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim	12
4. Çështje të ndjekura e të ankimuara në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre.....	12
5. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucionet	13
5.1. Bashkëpunim me institucionet të përcaktuara në ligjin 133/2015	13
5.2. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të Kapitullit 23 “Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore”, në zbatim të ligjit 133/2015	14
5.3. Raportime periodike Mijore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)	15
6. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të ATP-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes, të trajtuara nga ATP.....	16
6.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së	16
6.1.1. Nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese	17
6.1.2. Në sportelet e Marrëdhënieve me Publikun për periudhën <i>janar-dhjetor 2020</i> janë depozituar 1756 kërkesa qytetare, nga të cilat rezultojnë	17
6.1.3. Dokumente të trajtuar nga sektori i Arkivës ATP.....	18
6.2. Ankesa të trajtuara të ardhura nga portali i bashkëqeverisjes	18
6.2.1. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer raportimin periodik për vitin 2020 në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023	18
6.2.2. Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar ankesat të paraqitur nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.....	19
6.3. Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA	19
7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit	20

Hyrje

Agjencia e Trajtimit të Pronave është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe ushtron aktivitetin në zbatim të Ligjit 133/2015 *“Për Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”* si dhe akteve nënligjore VKM nr.221/2016; VKM nr.222/2016 e ndryshuar me VKM nr.765/ 2017; VKM nr.223/2016 të ndryshuar me VKM nr.766/2017 me VKM nr.1114/2020.

Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), në zbatim të pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.221, datë 23.3.2016, *“Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave”*, paraqet raportin vjetor të punës për periudhën janar-dhjetor 2020. Ky raport reflekton punën e ATP përgjatë vitit 2020 duke dhënë informacionin për objektivat e arritura gjatë këtij viti.

Në datën 7 maj 2020, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), publikoi vendimin *“Beshiri k.Shqipërisë dhe 11 kërkesa të tjera”*, kërkesa nr.29026/06. Në përfundim të procesit, Gjykata në përputhje me Nenin 35 të Konventës ka vendosur t’i shpallë kërkesat të pa pranueshme.

Me date 24.12.2020 u miratua me VKM nr.1114, datë 24.12.2020 për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 223, datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”*.

Agjencia e Trajtimit të Pronës ka përfunduar një nga proceset më të rëndësishme, që është ai i Vlerësimeve financiare të vendimeve përfundimtare për vitet 1993-2013/4 që kanë njohur të drejtën e kompensimit me qëllim nxjerrjen e një fature financiare përfundimtare.

Për gjatë pesë viteve ATP ka vijuar me Kompensimin financiar dhe fizik i vendimeve përfundimtare dhe **ka ekzekutuar 788 kërkesa** nga subjektet, **me vlerë financiare rreth 7.564 mld lekë** dhe shpërndarë fond fizik nga **fondi i tokës 713.2 ha**. Ndërsa për periudhën 10 vjeçare, nga hyrja në fuqi e ligjit, ATP është e ngarkuar që të kryej ekzekutimin e vendimeve përfundimtare që janë vlerësuar financiarisht sipas mënyrës dhe të formave të përcaktuara në VKM 223/2016, të ndryshuar. ATP do të vijojë më tej me ekzekutimin e aplikimeve të administruara si dhe aplikimet e reja që do të vijnë sipas akteve nënligjore për 5 vitet në vijim.

Për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie (proces i përfunduar më 23.02.2019) ATP-ja ka proceduar pas përfundimit të afatit për kërkesat e patrajuara mbështetur në pikën 2 të nenit 34 të Ligjit Nr. 133/2015, në të cilin citohet se: *Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t’i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre, sipas përcaktimeve të këtij ligji”*.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione *për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore*. Përditësimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATP-së kryesisht www.atp.gov.al.

1. Zbatimi i Rekomandimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në zbatim të vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Vendimit Beshiri k.Shqipërisë dhe 11 kërkesa të tjera, i cili u dha në 7 Maj të vitit 2020, nga gjykata u lanë disa detyra:

- (i) *të sigurojë kompensimin e jo më pak se 10% të vlerës totale që do të kishin përfituar kërkuarit, nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer, duke i'u referuar zërit aktual kadastral të pasurisë së shpronësuar;*
- (ii) *të parashikojnë indeksimin e shumës së kompensimit deri në pagesën përfundimtare, dhe zbatimin e Konventës në praktikë;*
- (iii) *Gjykata ka kërkuar që 11 çështjeve të këtij grupi duhet t'i jepet mundësia nga autoritetet vendase, për shqyrtimin e ankesave të tyre administrative apo gjyqësore.*

Me qëllim zbatimin e rekomandimeve të GJEDNJ si dhe vlerësimit të proceseve të brendshme nga ana e ATP-së, si dhe përmirësimin dhe lehtësimin e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit subjekteve të shpronësuar, u ngrit një grup pune me Urdhër të Kryeministrit Nr.88/2020, për *“Marrjen e masave individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 07.05.2020 “Beshiri kundër Shqipërisë dhe 11 kërkesa të tjera.*

Agjencia e Trajtimit të Pronave, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit, hartuan ndryshimet përkatëse në Vendimin nr. 223, datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”,* i cili u miratua me VKM nr.1114, datë 24.12.2020:

Ndryshimet konsistojnë:

1. Vlerësimi financiar i vendimeve që preken nga ndryshimi i zërit kadastral në kohën e shpronësimit me zërin kadastral aktual.

Nëpërmjet këtyre ndryshimeve brenda afatit 3 muaj të vitit 2021 do të kryhet përlllogaritja e vlerës financiare me shtimin e saj me 10% të vlerës sipas zërit kadastral aktual sipas rekomandimeve të GJEDNJ. Nga këto ndryshime do të preken afërsisht 10 120 subjekte që vlera fillestare e vlerësimit do të rishikohet me qëllim vetëm për të përfituar më tepër. Fatura financiare që do të përfitojnë më tepër pronarët parashikohet të jetë afërsisht 18.2 Mld lekë. Kjo vlerë e shtuar financiare mbetet dhe mbulohet brenda fondit total prej 50 Mld lekë të parashikuar në ligjin nr. 133/2015.

2. Vendimet e kompensimit që do të ekzekutohen do të indeksohen me normën e interesit nga momenti i plotësimit të dokumentacionit deri në momentin e ekzekutimit.

Çdo vendim përfundimtar do të rillogaritet duke i dhënë dhe indeksimin e normës së interesit nga momenti i plotësimit të dokumentacionit sipas formularit deri në momentin e ekzekutimit.

3. Ndryshime të tjera sa i përket lehtësimit procedural dhe përfitimit financiar

a.Kompensimi me 100% (cash) për vendime me vlerë financiare deri në 1.500.000 lekë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, bëhet e mundur që të aplikojnë dhe përfitojnë 10 085 subjekte, të cilët do të kompensohen financiarisht me vlerë financiare të plotë. Me këtë ndryshim do të kompensohen rreth 60 % e vendimeve nga 18 730 që janë gjithësej.

b. Heqja e bashkimit të vendimeve që kanë njohur të drejtën për kompensim. Rezultojnë rreth 3 708 vendime ku një subjekt ka minimalisht dy vendime me të njëjtin emër ish pronari. Bashkimi i vendimeve për subjektet që kishin një vendim me vlerë pozitive dhe një vendim me vlerë të ezauruar (negative), i ndalonte subjektet të shprehnin interesin për të aplikuar, pasi iu ulej vlera financiare që duhet të përfitonin.

c. Publikimi i vendimeve të cilat janë konstatuar me të meta nga ATP, nga subjekti kërkues apo gjykata, të cilat nuk janë publikuar apo janë publikuar me gabime materiale apo dhe mos plotësimit me dokumentacion nga ana e subjekteve. Kjo ndërhyrje bëhet me qëllim shmangien e problematikave që kanë patur subjektet me përfundimin e afatit 3 vjeçar të ligjit për vlerësimin e vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit. Me këtë ndryshim pritet që shumë subjekte të mos i drejtohen më gjykatave për vlerësim financiar të vendimit por ky proces do të ezaurohet nga vetë administrata e ATP-së.

d. Mundësia e rivendosjes në afat të subjektit për kompensim në rastet kur nuk e ka ushtruar të drejtën e heqjes dorë nga parablerja. Disa subjekteve iu ka humbur e drejta e parablerjes për shkak se prona është privatizuar pa dijeninë e tyre. Duke e patur praktikisht të pamundur për ta ekzekutuar të drejtën e kompensimit të fituar me vendimim përfundimtar si dhe vështirësia ekonomike e subjekteve për t'ju drejtuar gjykatave, u konsiderua e arsyeshme ndërhyrja dhe dhënia e mundësisë për të ushtruar të drejtën e heqjes dorë nga e drejta e parablerjes.

e. Heqja e detyrimit të hartave shoqëruese në fazën e ekzekutimit të vendimeve për rastet kur prona është zënë nga liqenet artificiale dhe kur prona është vlerësuar me vlerë financiare nga ish komisionet. Nga këto ndryshime do të përfitojnë rreth 8 049 subjekte të cilat kanë mungesë të hartës. Gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve të gjithë subjektet janë të detyruar të dorëzojnë hartën e vendimit pasi më parë duhet të drejtoheshin në gjykatë për ta ribërë këtë.

Ndryshimi dhe miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave për fondin pyjor dhe kullosor.

Një ndërhyrje pozitive e cila u arrit përgjatë vitit 2020 nga ATP-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë ishte ndryshimi në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, me vendimin nr.684, datë 02.09.2020, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”.

Ndryshimi në Vendimin nr.684/2020 detyron që sipërfaqet e transferuara në pronësi të bashkive, të cilat janë pjesë e fondit pyjor e kullosor publik të përcaktuara për t'u përdorur për kompensim fizik, bazuar në vendimin nr. 1077, datë 18.06.2008, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Fondit të Kompensimit Fizik nga Fondi Pyjor dhe Kullosor”, **nuk janë objekt i kalimit në pronësi, dhënies me qera apo i kontraktimit me të tretët nga bashkitë përkatëse. Këto sipërfaqe mbeten në dispozicion të Agjencisë të Trajtimit të Pronave për kompensim fizik.**

ATP në lidhje me këtë proces ka vijuar punën duke dërguar propozimet përkatëse në Ministrinë e Drejtësisë për ndryshimin e VKM-në nr. 1077, datë 18.06.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullosor cila sipërfaqen prej 71 699,3 Ha, kalon në fondin e kompensimit fizik dhe vihet në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, me qëllim detyrimin e ASHK-së të kryejë rregjistrimin në emër të ATP-së për të gjithë pronat e dhëna nga ky vendim.

2. Vlerësimi dhe ekzekutimi financiar i vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit

2.1. Përditësimi dhe Vlerësimi Financiar i Vendimeve përfundimtare

Agjencia e Trajtimit të Pronave nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në mbylljen e procesit të vlerësimit ka vlerësuar ***gjithsej 26 091 vendime*** përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013 me një vlerë prej **101,012,458,498 lekë**.

Gjatë periudhës **janar-dhjetor 2020** janë përditësuar **43 vendime** që kanë njohur të drejtën e kompensimit. Përditësimet janë kryer për shkak si më poshtë:

a-saktësim të sipërfaqes së njohur për kompensim pasi është shtuar edhe sipërfaqja e njohur me të drejtë parablerje pas dorëzimit të deklarates noteriale për heqje dorë nga kjo e drejte .


b-saktësim të emrave të subjekteve të shpronësuar, shtimin apo heqjen e tyre referuar vendimeve gjyqësore që kanë rregulluar bashkëpronësinë pas vendimarrjes së ish-KKKP.

c-saktësim, heqje ose përcaktim i parcelave me mbivendosje pas verifikimit nga grupet e punes me indicie të subjekteve.


d-saktësim i Zonave Kadastrale për parcelat të njohura për kompensim.

Të gjitha përditësimet janë bërë publike në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Vlerësimi financiar i vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit



Numri total i Vendime të dhëne në vite dhe të vlerësuara sipas ligjit 133/2015:



2.2. Kompensimi financiar i vendimeve përfundimtare

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, janë regjistruar pranë sporteleve **67 aplikime** të reja për kompensim financiar / fizik dhe ka vijuar procesi i shqyrtimit të dosjeve të cilat janë depozituar më parë të cilët do të trajtohen me vendim. Për aplikimet e bëra, subjektet janë njoftuar për të bërë plotësimet përkatëse të dokumentacionit të munguar si dhe janë dërguar shkresa pranë institucioneve të treta për konfirmim të dokumentacioneve. Gjatë muajit mars, prill ka patur një bllokim të konfirmimeve nga ana e institucioneve për shkak të situatës së krijuar me infeksionin covid-19, në zbatim të urdhërimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale për mos hapjen e sporteleve në shërbim të qytetarëve dhe vijimin vetëm të shërbimeve on line.

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, ATP ka vijuar procedurat **për kompensim financiar / fizik**, dhe rezultun :

- ▶ Janë administruar **67 aplikime** të reja;
- ▶ Janë ekzekutuar **25 vendime** me vlerë financiare dhe **1 vendim** është mbyllje procedimi;
- ▶ Është shpërndarë Fondi Financiar, **në vlerë prej 49,115,904.46 lekë**
- ▶ Nga Fondi i Tokës është shpërndarë një sipërfaqe prej **1,009,645.2 m²** e barazvlefshme me një vlerë financiare prej **196,463,618.04 lekë**.

Për kompensimin financiar me *kërkesë të veçantë*:

Gjatë periudhës **Janar - Dhjetor 2020**, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve me kërkesë të veçantë rezultun:


- ▶ Janë administruar **55** kërkesa të reja;
- ▶ Janë trajtuar me vendim **80 aplikime**, nga të cilat për **75 aplikime** ATP ka vijuar me levrimin e kësteve, ndërsa **për 5 aplikime** është vendosur mbyllje e procedimit administrative;

- ▶ Fondi i akorduar i cili do të *lëvrohet përgjatë viteve* për këto **75** vendime është në total **vlera 805,983,436.71 lekë**.
- ▶ ATP ka lëvruar vlerën **175,441,434.10 lekë**;
- ▶ Kursimi i Buxhetit të Shtetit nga kjo formë kompensimi është **1,252,744,470.90 lekë**;
- ▶ Gjithashtu, në fillim të vitit kalendarik është lëvruar kësti i rradhës për **148 aplikime** përgjatë viteve 2016-2019, të cilat kanë marrë kestin e dytë, të tretë dhe kestin e katërt, në vlerën **481'216'781.02 lekë**.

Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka shpërndarë për 788 vendime kompensimin financiar me një vlerë prej 7,564,269,098.38 lekë, në periudhat si vijon:

- ▶ **Gjatë vitit 2016** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1, 826, 870, 845 lekë** (një vlerë prej **1 805 417 553 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **21, 453, 292 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2017** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **2 056 845 314 lekë** (një vlerë prej **1 959 411 055 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **97 434 259 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2018** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1 543 025 978, 56 lekë** (një vlerë prej **35 521 553 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **1 507 504 425, 56 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2019** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **1,282,427,619.21 lekë** (një vlerë prej **113,786,500.63 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **1,168,641,118.58 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);
- ▶ **Gjatë vitit 2020** u shpërnda një fond për kompensim financiar prej **855,099,341.17 lekë** (një vlerë prej **49,115,904.46 lekë** për kompensim financiar dhe një vlerë prej **805,983,436.71 lekë** për kompensim financiar me kërkesa të veçanta);

Paraqitje Grafike e fondit financiar të shpërndarë 2016-2020



Nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015, Agjencia e Trajtit të Pronave ka shpërndarë nga Fondi Fizik i pronave një sipërfaqe prej **713.22 Ha**, me një vlerë financiare prej **1,445,773,530.42 lekë**, si vijon:

- ▶ **Gjatë vitit 2016** u shpërnda një sipërfaqe prej **658 899 m2 (65.9 ha)** me një vlerë financiare prej 140,425,603 lekë.
- ▶ **Gjatë vitit 2017** u shpërnda një sipërfaqe prej **2 575 064 m2 (257.5 ha)** me vlerë financiare 522,796,506 lekë.
- ▶ **Gjatë vitit 2018** u shpërnda një sipërfaqe prej **568 909 m2(56.9 ha)** me një vlerë financiare prej 116 637 991 lekë;
- ▶ **Gjatë vitit 2019** u shpërnda një sipërfaqe prej **2,319,678.46 m2(231.97 ha)** me një vlerë financiare prej 479,449,812.38 lekë;
- ▶ **Gjatë vitit 2020** u shpërnda një sipërfaqe prej **1,009,645.20 m2(100.96 ha)** me një vlerë financiare prej **196,463,618.04** lekë.


Paraqitje Grafike e fondit fizik të shpërndarë 2016-2020



Nga hyrja në fuqi e ligjit të ri janë kryer ekzekutime të vendimeve për kompensim si në tabelë:

Indikator ATP		Indikator të ATP në zbatim të ligjit 133/2015 periudha 2016-2020						
		2016	2017	2018	2019	2020	Totali 2016-2020	
Kompensimi financiar	Numri vendimmarrjeve I	186	167	16	59	25	453	
	Mbyllje procedimi	11	16	2	22	1	52	
	Vlera e kompensimit (leke)	1,805,417,553	1,959,411,055	35,521,553	113,786,500.63	49,115,904.46		3,963,252,566.09
	Sipërfaqe kompensuar m2	658,899	2,575,064.98	568,909	2,319,678.46	1,009,645.20		7,132,196.64
Kompensimi financiar I kërkesave të Vecanta	Numri vendimmarrjeve I	4	12	86	86	75	263	
	Mbyllje procedimi			4	11	5	20	
	Vlera financiare e llogaritur	21,453,292	97,434,259	1,507,504,426	1,168,641,118.58	805,983,436.71		3,601,016,532.29
	Vlera e kestit të pare	15,852,437	52,748,653	538,001,692	250,593,882.03	175,441,434.10		1,032,638,098.13
	Fondi kursyer buxhetit të shtetit	70,416,155	251,197,331	3,010,751,267	1,808,648,186.82	1,252,744,470.90		6,393,757,410.72
total							788	7,564,269,098.38

Paraqitje Grafike e fondit të kursyer buxhetit të shtetit nga kompensimi me kërkesa të vecanta, pas miratimit të ligjit 133/2015 (2016-2020)



2.3. Për përfitimin e shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)

Pranë ATP-së kanë aplikuar **1479** qytetarë për periudhën janar-dhjetor 2020, rezulton:

- Janë ekzekutuar gjithsej **997** kërkesa dhe është shpërndarë vlera financiare prej **1,215,971,969.51** lekë.

2.4. Për procesin e tjetërsimit të sipërfaqeve të shtetërore (oborreve në përdorim)

Agjencia e Trajtimit të Pronave bazuar në VKM nr. 578 datë 29.08.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim", ndryshuar me VKM nr. 790 datë 14.11.2012. Për një ndryshim në vendimin nr. 578, datë 29.08.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim".

Gjatë periudhës **janar – mars 2020**,rezulton se;

- Kanë aplikuar gjithsej **28 subjekte** nga Bashki të ndryshme;
- Janë kryer verifikime në terren për: 40 dosje ;
- Janë kryer vlerësime tekniko ligjore: 36 dosje ;
- Janë me vendimmarrje **33 kërkesa**.

Për periudhën **prill-dhjetor 2020** me hyrjen ne fuqi te ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare te pronësisë ne Republikën e Shqipërisë", në Agjencinë e Trajtimit të Pronave nuk mund të vijonte më shqyrtimin e dosjeve të kalimit në pronësi të oborreve në përdorim , pasi ka kaluar si funksion pranë ASHK-së.

Në zbatim të pikës 4, të nënit 70 të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së Nr. 109, datë 20.05.2020, Për "Evidentimin, klasifikimin dhe Inventarizimin e dosjeve te oborreve ne përdorim, ne administrim te Agjencisë se Trajtimit te Pronave", Urdhrit Nr.136, datë 29.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së, për "Ngritjen e grupit të punës për dorëzimin e dosjeve të oborreve në përdorim Agjencisë Shtetërore të Kadastrës", si dhe Urdhrit Nr. 1911, datë 20.07.2020 të Drejtorit të

Përgjithshëm të ASHK-së, për “Ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe marrjen në dorëzim të praktikave të "Oborreve në përdorim", në ATP pasi është realizuar evidentimi, klasifikimi, inventarizimi dhe njësimi me origjinalin i **2213 dosjeve** të përfunduara me vendim, **Janë dorëzuar 2213 dosje nga arkiva e ATP pranë arkivës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me proces-verbalin nr.7169 Prot, datë 25.08.2020.**

3. Trajtimi i numrit të kërkesave të paraqitura nga subjektet e shpronësuara

3.1.Dorëzimi i kërkesave të patrajuara për njohje pronësie tek subjektet dhe inventarizimi i tyre në arkiv.

ATP ka regjistruar në total **16 462** kërkesa të patrajuara (kërkesa të depozituara me ligjet e mërpërshme dhe kërkesa të reja sipas ligjit 133/2015), Gjatë periudhës 3 vjecare janë trajtuar me vendim **9512** kërkesa, ndërsa për **6950** subjekte janë njoftuar të tërheqin dokumentat pranë ATP-së.

Në Agjencinë e Trajtit të Pronave për periudhën **janar-dhjetor 2020** rezulton se:

- ▶ Janë depozituar **491 kërkesa** nga subjektet për të tërhequr dokumentacionin tekniko/ligjor në dosjet respektive. Totali nga shkurt 2019 deri dhjetor 2020, është **3688** kërkesa për tërheqje dokumentacioni.
- ▶ Dosje të tërhequra nga subjektet për periudhën janar –dhjetor janë gjithësej **363 dosje**. Totali nga mars 2019 – dhjetor 2020 janë tërhequr **3472 dosje**.
- ▶ Janë kryer **293** kthim përgjigje subjekteve kërkuar dhe institucioneve zyrtare me objekte të ndryshme në kërkesat e tyre.
- ▶ Janë trajtuar **60** kërkesa në lidhje me analizimin e dokumentacionit tekniko/ligjor, referuar kërkesë padive të përcjella dhe të aplikuara pranë Gjykatës së Rrethit ku ndodhet prona, si dhe pranë Gjykatave të Apelit. Këto vlerësime janë bërë për të ndihmuar procesin e njohjes së pronësisë në gjykatë, si dhe mbrojtjes së vendimmarrjeve të apeluara nga subjektet. Theksojmë se analizimi i kryer është në kuadrin e një vlerësimi ligjor të mirëfilltë.
- ▶ Parapërgatitja e procedurave për rreth 3400 dosje/praktika (*dorëzimin e dokumentacionit*), të cilat ndodhen në sektor me qëllim procesimin e shpejt të kërkesave të cilat do të paraqiten nga subjektet.
- ▶ Arkivimi i **1318** dosje/praktika, pas përfundimit të procedurave administrative.

Nr.	Emertimi i procedurave	numri
1	Nr.total i dosjeve per trajtim	16462
2	Nr. dosjeve te trajtuara me vendim	9512
3	Nr. dosjeve te patrajuara	6950
4	Nr.njoftimeve per terheqje dosje	6950
5	Kerkesa te subjekteve per terheqje dosje	3688
6	Nr.dosjeve te terhequra	3472

3.2. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim

Në zbatim të ligjit 133/2015, "Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave", VKM-së nr.222 datë 23.02.2016, "Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj" dhe VKM-së nr.770/2014 "Për Kalimin në Fondin e Kompensimit Fizik, në Dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej **23 368.8 Ha**", nga ATP për periudhën janar-dhjetor 2020, ka proceduar si vijon:

- ▶ Ngritja e grupit të punës me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 8 prot, datë 09.01.2020 për evidentimin e Fondit Pyjor Kullosor, të një sipërfaqe prej 71. 699,3 ha, e cila kalon si fond kompesimi fizik ne dispozicion të ATP, sipas tabelës bashkëlidhur vendimit.
- ▶ Janë kryer verifikime në institucionet e treta, si Drejtorite e Sherbimit Pyjor, Agjencitë Shtetërore të Kadastrës për mbledhjen e materialit të nevojshëm për evidentimin e fondit pyjor-kullosor, si dhe verifikime në terren, të ngastrave pyjore, ekonomive pyjore, sipas tabelës së fondit ne qarqet Tiranë, Gjirokastrë, Berat, Fier, Vlorë.
- ▶ Pasi është mbledhur materiali i nevojshëm është bërë përpunimi i materialit bruto digjital dhe me pas është bërë evidentimi i ngastrave pyjore kullosore në hartë, pra pozicionimi i tyre gjeografikisht. Kjo hartë do të pasqyrohet në sistemin Web-Gis pasi të bëhet regjistrimi i tyre pranë zyrave vendore të ASHK-së.
- ▶ ATP-ja ka bërë korrespondencë me Agjencite Shtetërore të Kadastrës për sa i përket statusit juridik të pasurive te evidentuara nga fondi pyjor-kullosor, si dhe diskutim mbi procesin e kalimit në favor të ATP-së për tu përdorur si Fond Kompensimi Fizik.

Nga ATP për periudhën **Janar-dhjetor 2020** është evidentuar në total një sipërfaqe prej rreth **18 000 Ha** nga fondi pyjor kullosor.

4. Çështje të ndjekura e të ankimuara në gjykatë dhe ekzekutimi i tyre

ATP është përfaqësuar në dy shkallët e gjyqësorit civil dhe në atë Administrativ për vendimet e dhëna ndër vite, bazuar në legjislacionin në fuqi, si vijon:

Nga Përfaqësimi Ligjor pranë gjykatave; për periudhën janar –dhjetor 2020 rezulton se:

- ▶ Janë depozituar **896 padi** në të gjitha gjykatat e vendit: në gjykatat e rretheve, në gjykatat e apelit, në gjykatat administrative të shkallës së parë dhe në apelin administrativ.
- ▶ Janë mbyllur me vendim **804** çështje;
- ▶ **166** padi janë rrëzuar;
- ▶ **274 padi** kanë përfunduar me kthimin e akteve apo me pushimin e çështjes;
- ▶ Janë ushtruar **107 ankime** dhe **108 rekurse**. Total **215**.

Për periudhën janar deri më 31 dhjetor 2020 pranë ATP-së janë depozituar:

- ▶ Në lidhje me vendimarrjen e ATP sa i takon njohjes të së drejtës së pronësisë sipas kushteve të nenit 29 të ligjit 133/2015 janë administruar **48 padi** dhe rezultojnë:
 - Pranuar 45 padi
 - Rrezuar 8 padi
 - Kthim aktesh dhe pushuar 29 padi

- ▶ Në lidhje me vlerësimet financiare për vendimet që kanë njohur të drejtën e kompensimit sipas kushteve të **nenit 19** të ligjit 133/2015 janë depozituar në ATP **22 padi** ku kundërshtohet vlerësimi financiar i vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit, rezultojnë:
 - Janë pranuar **25 padi**
 - Rrëzuar **25 padi**
 - Kthim aktesh ose pushuar 1 padi
- ▶ Pas mbylljes së afateve ligjore për shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie, si dhe vlerësimeve financiare të vendimeve që kanë njohur të drejtën e kompensimit sipas kushteve të **nenit 15** të ligjit 133/2015 janë depozituar:
 - 40 padi në Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë
 - Pranim 21 padi
 - Rrezuar 10 padi
 - Kthim aktesh pushuar 16 padi
- ▶ Në lidhje me procedurat sipas kushteve të **nenit 34** të ligjit 133/2015 janë depozituar:
 - **389 padi në Gjykatat e Shkallës së Parë Civile.**
 - Pranuar 41 padi
 - Rrezuar 29 padi

5. Bashkëpunimi dhe raportimi me institucionet

Agjencia e Trajtimit të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë kryesisht me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Avokaturën e Shtetit, Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

5.1. Bashkëpunim me institucionet të përcaktuara në ligjin 133/2015

ATP në kuadër të bashkëpunimit me institucionet ka trajtuar rreth 2000 shkresa, si dhe ka vënë në dispozicion materiale, dosje arkivore me vendime dhe harta bashkshoqëruese.

Bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit: U përmbyll me sukses me miratimin e ndryshimeve VKM nr. 223/2016 duke zbatuar dhe rekomandimet e GJEDNj-së në vendimin Beshiri kundër Shqipërisë. Gjatë vitit 2020 kanë bashkërenduar qëndrimet institucionale në rekursat që paraqiten pranë Gjykatës së Lartë, në kuadër të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile. Vijimi i bashkëpunimit kryesisht në proceset gjyqësore të cilat janë të një rëndësie të veçantë, duke analizuar, arsyetuar akt paditë e paraqitura nga palët si dhe pozicionimet e tyre në hartë. Është dhënë ekspertizë e specializuar tekniko inxhinierike.

Bashkëpunimi me ASHK-në: ATP dhe ASHK kanë ngritur grupe të përbashkëta për të propozuar akte nënligjore në kuadër të zbatimit të ligjit 20/2020. Është përfunduar me sukses inventarizimi dhe kalimi i dosjeve për procesin e tjetërsimit të sipërfaqeve shtetërore (oborre në përdorim). ATP ka inventarizuar dosje me vendim dhe pa vendim në cilësinë e fotokopjes 2 871 dosje në total dhe po këto dosje janë dërguar pranë ASHK-së. Gjithashtu janë kryer takime dhe korrespondenca për çështje të cilat janë konstatuar probleme gjatë vitit 2020, kryesisht kanë të bëjnë konfirmimet e gjëndjes juridike së pasurive për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI), për tarifimin e shërbimit në

kuadër të VKM nr.389/2020 “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, për regjistrimin e AMTP-ve , si dhe regjistrimin e titujve të pronësisë. Grupet e punës respektive janë duke punuar për të propozuar zgjidhje të cilat do të dalin në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të përcaktuar në nenin 57, të ligjit 20/2020.

Bashkëpunim me AKSHI-n: Në kuadër të masave për zbatimin e Urdhrit të Kryeministrit nr.153, prot, datë 25.11.2019 ATP ka përgatitur infrastrukturën përkatëse për të përfshirë të gjitha shërbimet online nga data 01.01.2021. ATP ka bashkëpunuar në lidhje me mirëmbajtjen e sistemit Web-gis duke informuar mbi kontratat si dhe për vijimin e mëtejshëm dhe nevojën për përmirësimin e sistemit Web – Gis në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të GJEDNj-së.

Bashkëpunimi me AIDA-n: ATP ka dërguar informacion në mënyrë të vazhdueshme mbi vendime të cilat janë dhënë nga ish komisionet si dhe është dhënë ekspertizë e specializuar tekniko inxhinierike. Ky informacion ka shërbyer për të krijuar një panoramë me të qartë mbi pronësinë, në lidhje me investimet strategjike, ku subjekte të ndryshme paraqesin kërkesa për investime.

Bashkëpunimi me Bashkitë: ATP ka dërguar informacion pranë Bashkive mbi vendime të cilat janë dhënë nga ish- komisionet. Informacioni i dërguar ju shërben Bashkive për prona të cilat i kanë në administrim dhe kërkojnë t’ia japin me qira komunitetit.

Bashkëpunimi me Ministrinë e Mbrojtjes: Gjatë vitit 2020 ATP dhe Ministria e Mbrojtjes kanë kryer takime në lidhje me përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve që janë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim kalimin e këtyre objekteve në pronësi të oficerëve për banim si dhe informacion për godinat e tjera që administrojnë dhe kërkojnë të nxjerrin në proces privatizimi.

Bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë: Është dërguar informacion në lidhje me vendime komisioni për prona të caktuara për objektet që kalojnë për privatizim nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike.

5.2. Raportime institucionale në kuadrin e zbatimit të Kapitullit 23 “Gjyqësorit dhe të Drejtat Themelore”, në zbatim të ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, siç vijon:

- ▶ Kontributi në lidhje me Rekomandimet e takimit të **11-të të Nënkomitetit të Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë**, të dërguara nga shërbimet e Komisionit Evropian, si dhe kontributi në lidhje me takimin e **12-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”**.
- ▶ Kontributi i dytë dhe tretë institucional me informacione të përditësuar për hartimin e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.
- ▶ Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përgatitur kontributin institucional për PKIE 2021-2023 dhe raportuar në MD, ku *identifikohen iniciativat ligjore institucionale që do të përfshihen në PKIE 2021-2023 dhe përputhshmëria me programet analitike të Projekt buxhetit për vitin 2021 dhe PBA 2021-2023*.
- ▶ Raportime lidhur me Planin e Masave për rekomandimet e Progres Raportit të vitit 2019, në lidhje me Kapitullin 23.
- ▶ Kontributi mbi zbatimin e “Strategjisë Ndër sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, raportimi 3 muhor, 6, muhor, 9 muhor dhe vjetor.

- Kontributi institucional “Për hartimin e dokumentit IPA III për fushën e EU justice and fundamental rights”, nga Agjencia e Trajtimit të Pronave është plotësuar sipas udhëzimeve Dokumenti “Përgjigje Strategjike”.
- Kontributi sipas fushave të përgjegjësisë që mbulon Agjencia e Trajtimit të Pronave lidhur me shkresën e dërguar nga Kuvendi me Nr.Prot.44 më datë 04.02.2020 për një raport të detajuar mbi zhvillimet e fundit në lidhje me 5 prioritetet në zbatim të rekomandimeve të Komisionit Evropian (Raport i Progresit 2019).
- Kontributi ATP-së “Mbi përditësimin e tabelës së kapaciteteve institucionale dhe administrative për nën fushën e te drejtave të njeriut, pjese e Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe te drejtat themelore” me informacion për vitin 2019 dhe periudhën raportuese të vitit 2020 në tabelat e kapaciteteve administrative.
- Përditësime të informacioneve lidhur me të dhënat të pronës, si një nga prioritetet e qeverisë.
- Raportime në MD, ditore dhe javore në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.89, datë 29.02.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore sipas fushës së veprimtarisë”
- Kontributi i katërt institucional për hartimin e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020, për **përparimin dhe arritjet e realizuara në periudhën 31 mars 2020 – 15 qershor 2020 (raportim vetëm për ato pika ku ka pasur zhvillime të reja)**.
- Raportime institucionale në zbatim të ligjit 133/2015 sipas afateve të përcaktuara 3 mujore, 6 mujore, 9 mujore dhe vjetore, për MD, KM, KP.
- Kontributi institucional me informacionin e nevojshëm me qëllim prezantimin e arritjeve të institucionit sipas fushave të përgjegjësisë institucionale për periudhën janar-dhjetor 2019 dhe janar-gusht 2020, për takimin e radhës të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, me temë: “Progresi i realizuar dhe sfidat në kuadër të Kriterit Politik, Kapitullit 23 dhe 24, me fokusin në 15 pikat e Vendimit të Këshillit të Bashkimit Evropian të datës 25 Mars 2020 për hapjen e Negociatave”.

5.3. Raportime periodike Mujore mbi 12 indikatorët për shërbimet ndaj qytetarëve pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS)


Evidence e raportimeve periodike mujore pranë ZOS për periudhën janar-dhjetor 2020

Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI
Aplikime të plota	451	484	162	67	243	454	493	353	470	443	372	483	4475
Aplikime të paplota	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A
Aplikime të mbartura	125	141	55	16	65	98	119	63	121	128	99	93	1123
Total i shërbimeve të levruara	177	195	69	16	65	209	192	105	156	177	128	135	1624
Sherbime të levruara brenda afatit	170	191	64	15	60	198	180	86	143	168	113	120	1508
Sherbime të levruara jashtë afatit	7	4	5	1	5	11	12	19	13	9	15	15	116
Plotesim dokumentacioni	10	9	12	1	2	24	10	9	4	3	7	6	97
Ankesa të reja	2	0	0	1	1	2	2	1	2	2	0	1	14
Ankesa të mbartura	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24
Nr.pergj I ankesave të zgjidhura/shqyrtuara	2	0	0	1	0	1	1	1	2	2	0	1	11
Nr.ankesash të zgjidhura/shqyrtuara brenda afatit	2	0	0	0	0	1	1	1	2	0	0	1	8
Nr.ankesash të zgjidhura/shqyrtuara jashtë afatit	0	0	0	1	0	0	0	0	0	2	0	0	23
Aplikime për kompensim nga ALUIZNI	119	119	10	32	104	111	157	170	171	120	131	235	1479

Aplikime per sherbime me vendimmarrje prane sektorit te tjetersimit te Oborreve	11	9	8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	28
Aplikime per kalimin e praktikave ne cilesine e dosjes prane sektorit te Shqyrtimit te Kerkeseve per Njohje Pronesie													0
Aplikime prane sektorit te kompensimit Financiar dhe Fizik	6	9	3	0	4	4	7	5	11	8	2	10	69
Aplikime per sherbime pa vendimmarrje	312	345	136	33	132	331	321	177	281	308	234	234	2844
Aplikime per Kompensim progresiv													0
Aplikime per kerkesa te vecanta	3	2	5	2	3	8	8	1	7	7	5	4	55

Raportime periodike Mujore pranë Zyrës Operacionale të Situatës, pranë Kryeministrit (ZOS) për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis.

Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	TOTALI
Nr I vendimeve ne dosjet e skanuara	75	4	26	17	14	207	65	1	0	24	26	1	460
Nr.vend.te hartografuara	6	1	0	1	0	60	2	0	1	2	0	0	73



6. Kërkesa të depozituara pranë sporteleve të ATP-së si dhe ankesa të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes, të trajtuara nga ATP.

6.1. Kërkesa të depozituara në sportelet e ATP-së


Për periudhën janar-dhjetor 2020 pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave në lidhje me shërbimet që ofrohen ndaj qytetarëve, janë trajtuar:

6.1.1. Nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese

- 2729 numri i shkresave hyrëse qytetare;
- 7162 numri i shkresave hyrëse zyrtare;
- 2980 numri i shkresave me përgjigje qytetare(total);
- 3844 numri i shkresave me përgjigje zyrtare(total).

Evidence e trajtimit të shkresave nga zyra e protokollit janar-dhjetor 2020 sipas 3 mujorëve.

Indikatoret	Treguesit statistikor	Periudha e raportimit				
		3 m1	3m2	3m 3	3m 4	Vjetore 2020
Trajtimi i shkresave në ATP, numri i shkresave hyrëse dhe të trajtuara me përgjigje	Numri i shkresave hyrëse qytetare	729	496	741	763	2729
	Numri i shkresave hyrëse zyrtare	783	680	2532	3167	7162
	Numri i shkresave me përgjigje qytetare(total)	693	350	950	987	2980
	Numri i shkresave me përgjigje zyrtare(total)	741	609	1327	1167	3844



6.1.2. Në sportelet e Marrëdhënieve me Publikun për periudhën janar-dhjetor 2020 janë depozituar 1756 kërkesa qytetare, nga të cilat rezultojnë

- Tërheqje dokumentacioni: 494
- Kopje dokumentacioni: 591
- Plotësim dokumentacioni: 276
- Informacion: 191
- Takim dhe kërkesa të ndryshme: 164
- Metodologji: 23
- Vlerësim Vendimi: 17

6.1.3. Dokumente të trajtuar nga sektori i Arkivës ATP

Në arkivën e ATP-së për periudhën janar-dhjetor 2020 rezultoi se janë ruajtur, administruar dhe përpunuar në total **1984** dosje dhe praktika të cilat kanë zbritur në arkiv nga sektorët dhe janë hedhur në sistemin Web-GIS, të detajuara si vijon:

- ▶ Janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **1301** dosje të tërhequra të cilat kanë zbritur në arkiv nga sek shqyrtimit dhe hedhur në sistemin Web-GIS;
- ▶ Janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **64** dosje me nenin 22 të cilat kanë zbritur në arkiv nga sek shqyrtimit dhe hedhur në sistemin Web-GIS;
- ▶ Janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **117** dosje me vendime të cilat kanë zbritur në arkiv nga sek shqyrtimit dhe hedhur në sistemin Web-GIS;
- ▶ Janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **326** dosje oborresh të cilat kanë zbritur në arkiv nga sek tjetërsimit të sip. dhe hedhur në sistemin Web-GIS;
- ▶ Janë ruajtur, administruar dhe përpunuar **176 praktika** të cilat kanë zbritur në arkiv nga sek shqyrtimit;
- ▶ Janë trajtuar me përgjigje **1936** kërkesatë adresuara Sek/Arkivës nga Institucionet dhe Qytetarët;
- ▶ Janë trajtuar me përgjigje **76** kërkesa të adresuar Sek/Arkivës nga Institucionet dhe Qytetarët në sistemin on-line SQDNE;
- ▶ Në zbatim të Urdhrit nr. **136**, datë **20.07.2020** të Drejtorit të përgjithshëm të ATP-së “Për ngritjen e grupit të punës për dorëzimin e dosjeve të oborreve në përdorim ASHK”, të Urdhrit nr. **109**, dt. **20.05.2020** bazuar në pikën 4 nenit 70 të Ligjit Nr.20/2020 Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Urdhrit nr. **1911** datë **20.07.2020** të Drejtorit të përgjithshëm të ASHK-së “Për ngritjen e grupit të punës për inventarizimin dhe marrjen në dorëzim të dosjeve të oborreve në përdorim” janë dorëzuar **2213** dosje të arkivuar nga Sek/Tjetërsimit të Sip.Shtetërore në Arkivë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës me proces-verbalin nr.**7169** Prot, datë **25.08.2020**

6.2. Ankesa të trajtuara të ardhura nga portali i bashkëqeverisjes

6.2.1. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka kryer raportimin periodik për vitin 2020 në kuadër të monitorimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023

Për periudhën janar-dhjetor 2020 nga Kontrolli dhe verifikimi (hetimi administrativ) i zbatimit të ligjshmërisë dhe i denoncimeve për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare në Agjencinë e Trajtimit të Pronave nga Grupi i Punës Anti Korrupsion është raportuar, si vijon:

- ▶ Në ATP është 0 (zero) numri i raporteve dhe inspektimeve nga Grupi i Inspektimit të ATP-së;
- ▶ Nuk ka patur asnjë raportim dhe për këtë arsye nuk është bërë asnjë inspektim dhe nuk është marrë asnjë masë;
- ▶ Nuk ka asnjë rast të referuar në Prokurori.

Në zbatim të dokumenteve strategjike të dërguara nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin dhe analizën, mbi zbatimin e planit të veprimit AK, për vitin 2020, po përgatit informacionin për raportimin e aktiviteteve dhe masave në formatin e raportimit të dërguar nga MD. Informacioni do të përgatitet

mbështetur në planin e ri të veprimit 2020-2023, së bashku me pasaportën e indikatorëve. Qasja me metodologjinë e re të raportimit dhe të analizës së zbatimit të masave antikorupsion të planit të veprimit të ri, sipas IPSIS, ka qenë një proces i ri për të cilën ATP ka kryer raportimin 6 muajor dhe 9 muajor dhe është në fazën e përgatitjes së raportit vjetor 2020.


Në vijim të këtij procesi nga ATP do të kryhet monitorimi/raportimi i indikatorëve të këtij plani veprimi për të pasur një vlerësim konkret të arritjes dhe të matjes së objektivëve të SNKK. Informacioni do të dërgohet në mënyrë narrative (analize) për aktivitete/masa dhe një analizë paraprake mbi arritjet.

6.2.2. Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar ankesat të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.

Nga janar deri në dhjetor 2020, janë trajtuar me përgjigje **181**, ankesa qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, të trajtuara me përgjigje, nga të cilat:

- 53 kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e kompensimit financiar/fizik.
- 24 kërkesa/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e vendimmarrjes për Njohjen e Pronësisë.
- 7 kërkesa/ankesa për Sektorin e Oborreve në përdorim
- 4 kërkesa/ankesa për Sektorin e Përfaqësimit Ligjor
- 36 kërkesë/ankesë e cila ka lidhje me procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensimin në vlerë të ish pronarëve tokat e të cilëve janë zënë me ndërtime informale
- 47 ankesa për Sektorin e Protokollit/Arkivës/Mardhënieve me Publikun

Indikatorët ATP	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Numri i kërkesë /ankesë të ardhura nga qytetarët në sportele dhe portale elektronike	5682	3895	6583	16136	2552	1621	667	181



6.3. Shërbime të ofruara nga ATP nga bashkëpunimi ndërmjet AKSHI dhe ADISA

6.3.1.Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të ATP-së me AKSHI-n dhe ADISA për krijimin dhe funksionimin e dy shërbimeve elektronike nga portali qeveritar e-albania, nga ATP-ja ka vijuar puna me shërbimet elektronike e bëra publike

Për vitin 2020 nëpërmjet portalit e-albania janë paraqitur **229 aplikime** nga të cilat:

- ▶ 150 aplikime -Ankesë dhe trajtimi i dosjes me specialistin përkatës pranë ATP
- ▶ 79 aplikime -Kërkese për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes

6.3.2.Në sistemin e qarkullimit të dokumenteve me nënshkrimin elektronik(SQDNE), janë paraqitur dhe trajtuar 163 aplikime.

Agjencia e Trajtimit të Pronave në kuadër të procesit të implementimit të shërbimeve vetëm online , në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 158 Prot., datë 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm online nga data 01.01.2020”, prej datës 31 Dhjetor 2020 e në vijim aplikimet sipas udhëzimeve institucionale për shërbimet e mëposhtme do të mundësohen shërbimet **vetëm on-line, nëpërmjet portalit E-Albania** :

- ▶ Aplikim për lëshim kopje dokumentacioni;
- ▶ Aplikim për kompensim financiar dhe fizik;
- ▶ Aplikim për kompensimin e pronave me kërkesë të veçantë;
- ▶ Aplikim për kompensim në ankand;
- ▶ Aplikim për kompensim në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale (ALUIZNI);

7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompesimit

Analiza e Buxhetit të vitit 2020 duke u bazuar në 12 muhor, i pa kuadruar nga dega e thesarit

7.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2020 duke u bazuar në 12 muhor , i pa kuadruar nga dega e thesarit					
Nr	Emertime	Llog. Ekonomike	Buxheti 2020 Aktin Normative nr. 34	Plani 12 Muhor	Fakti 12 Muhor
1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	600	132,000,000	132,000,000	127,526,468
2	ndrituri i sigurimeve shoqerore dhe shendetësore	601	22,000,000	22,000,000	21,162,853
3	Mallra dhe shërbime te tjera	602	51,196,000	51,196,000	35,028,748
4	Transferime korrente të brendshme	604	1,900,000,000	1,900,000,000	1,900,000,000
4	Transferime korrente të brendshme (transferat e te ardhurave Kapitull 6 te ATP ne BSII)	604	16,096,293	16,096,293	16,096,293
5	Transferta per Buxhetet familiare dhe individet(Fond I VECANTA)	606	200,000	200,000	30,000
6	Shpenz. Për rritjen e aktivev të Trupëzuara	231	1,000,000	1,000,000	450,240
	Totali Buxhetor 1		2,122,492,293	2,122,492,293	2,100,294,602
7	Te Ardhura Jashtë Buxhetore		1,000,000,000	1,000,000,000.00	898,823,806.29
	Totali 2		1,000,000,000	1,000,000,000.00	898,823,806.29
	TOTAL Buxhetore dhe Jashte Buxhetore(Total 1+Total 2)		3,122,492,293	3,122,492,293	2,999,118,408

7.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, per vitin 2020

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Total	Komente
1	Tarifa për Aktet - Administrative	7110105	3,736,090.00	Perjudha 12 Mujore
2	Të ardhura nga Tjetërsimi i Sipërfaqeve Shtetërore	7110114	15,100,001.00	Perjudha 12 Mujore
3	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	7111099	-	
4	Të ardhura të krijuara nga pagesa e vlerës së llogaritur të tokës	7109901	678,000.00	Perjudha 12 Mujore
5	Të ardhura nga kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtëshme e të truallit funksional të tyre	7109902	-	Perjudha 12 Mujore
6	Të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive shtetërore	7109903	83,307.00	Perjudha 12 Mujore
7	Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene	1161110	234,985.00	Perjudha 12 Mujore
8	Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 70%	7116101	1,129,523,384.19	Perjudha 12 Mujore
9	Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 50%	7116102	31,120,465.00	Perjudha 12 Mujore
TOTAL			1,180,476,232.19	

Totali 2+4+6+7		16,096,293.00	Të ardhura që ju shtuan ATP në fondin e kompensimit, te cilat kaluan ne bankën e Shqipërisë
Totali 8+9		1,160,643,849.19	Të ardhura që i shtohen ATP për kompensimin e pronarëve për tokat e zëna nga ndërtimet informale (Aluizni), në pritje për kalimin në thesar për në bankën e Shqipërisë

Informacioni I te ardhurave eshte I pakuadruar nga thesari

7.3 Informacionin Sa leke jane shpenzuar per Aluiznin, Kompensim sipas se drejtes se njohur, Kompensim me raste te vecanta 12 Mujor

	Totali	1,921,746,089.09	Nr.Subjekteve	Nr.Subjekteve/ mbyllje procedimi
	Xhirime Aluzini	1,215,971,969.51	997	
	Raste Te vecanta	656,658,215.12	223	4
	Kompensim financiar	49,115,904.46	25	1

Mbi rekomandimet e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të lënë në raportin vjetor 2019 i cili u raportua nga ATP në muajin maj 2020.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, hartoi raportin mbi diskutimet dhe pyetjet që u bënë nga anëtarët e komisionit dhe la disa rekomandime të cilat duhet të ishin në vëmendje të ATP-së gjatë veprimtarisë për vitin 2020.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, rekomandon Agjencinë e Trajtimit të Pronave për vitin 2020 të marrë disa masa dhe konkretisht:

1. Të intensifikojë veprimtarinë e saj në drejtim të:

a. vijimit të procedurave të kompensimit financiar të vendimeve përfundimtare, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga ligji nr.133/2015 dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij.

ATP-ja gjatë vitit 2020 ka ekzekutuar vendime që kanë njohur të drejtën e kompensimit, por shkak i ecurisë së dobët ka qënë vetë pretendimi i pronarëve për të mos vijuar me procesin e ekzekutimit, duke qënë në pritje të vendimit të GJEDNj-së, me qëllim përmirësimin e kushteve të kompensimit. Si rrjedhojë e vendimit Beshiri kundër Shqipërisë si dhe ndryshimeve të VKM 223/2016, vlerësojmë se procesi do të vijojë me hapa të shpejtë dhe do të përmbyllet brenda afatit të përcaktuar në ligjin 133/2015.

b. vijimit të procesit të kompensimit për pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimet informale, bazuar në aktet nënligjore të miratuar për këtë qëllim.

Janë ekzekutuar kërkesa në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM si dhe në bazë të fondit të alokuar nga ana e ASHK-së.

c. vijimit të procedurave të ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë.

ATP-ja ka ekzekutuar gjatë vitit 2020 çdo vendim gjyqësor të formës së prerë, ku ka qënë debitorë. Kërkesat e pa ekzekutuar të cilat janë publikuar dhe në faqen zyrtare të ATP-së nuk janë ekzekutuar për shkak të mos plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm të pezullimit të tyre nga ana e gjykatës apo si pasojë e mospranimit të kreditorit që ti nënshtrohet kriterëve të ligjit 133/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.

2. *Të ndjekë efektivisht të gjitha proceset gjyqësore, në të cilat Agjencia e Trajtimit të Pronës është palë si dhe të bashkëpunojë dhe të koordinojë mbrojtjen gjyqësore me Avokaturën e Shtetit.*

ATP ka bashkëpunuar ngushtësisht me Avokaturën e Shtetit në të gjitha proceset gjyqësore ku jemi palë me qëllim për realizimin e një përfaqësimi dhe mbrojtje efektive, çështjeve gjyqësore me qëllim mbrojtjen e interesave të shtetit, në gjykatat e të gjitha niveleve, të cilat janë me objekt të drejtën e njohjes së pronës, vlerësimit dhe kompensimit të saj, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin 133/2015 dhe akteve nënligjore të tij.

ATP-ja ka informuar dhe ka siguruar me dokumentacionin/provat që disponon për çdo çështje në gjykim Avokaturën e Shtetit. Ka mundur të përpilojë relacion të detajuar për çdo çështje që kërkohet nga ASHK, duke përfshirë dhe qëndrimin ndaj kërtimeve të paditësit. Ka dhënë qëndrimin profesional teknik (hartografik), për vijueshmërinë me sukses të çdo procesi gjyqësor.

3. *Të intensifikojë përpjekjet për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Task-Forca për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore duke përfshirë këtu edhe ushtrimin e të drejtës së ankimit bazuar në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale Penale, ndaj vendimeve të mosfillimit të procedimit penal dhe pushimit të çështjes, për kallzimet penale të paraqitura nga Agjencia e Trajtimit të Pronës. Të bashkëpunojë me Avokaturën e Shtetit për të ndjekur mbrojtjen e interesave pasurorë të shtetit në gjykimin penal në përputhje me legjislacionin në fuqi për Avokaturën e Shtetit.*

Në kuadër të ndjekjes me prioritet të rekomandimeve të Task Force, ATP-ja për vitin 2020 ju informon se:

Për 7 (shtatë) vendime të depozituara nga Gjykatat dhe Prokuroria

- 3 janë pushime të çështjes penale pasi fakti nuk ekziston ose është parashkruar;
- 2 janë deklarime fajtor të subjekteve;
- 1 është ushtruar rekurs penal nga Avokatura e Shtetit;
- 1 është dërgim i çështjes penale në gjykatë nga prokurori i çështjes;
- 1 është lënie në fuqi të vendimit të gjykatës për pushimin e çështjes;

4. *Të vijojë me zbatimin e rekomandimeve të evidentuara në Progres-Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë.*

ATP ka raportuar në mënyrë periodike nëpërmjet Avokaturës së Shtetit pranë GJEDNJ-së dhe Këshillit të Ministrave në Strasburg për implementimin dhe ecurinë e ligjit 133/2015.

ATP është institucion që ka raportuar gjatë vitit 2020 në kuadër të Kapitullit 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", në të gjithë Nënkomitetet e Bashkimit Evropian si Drejtësia, Liria dhe Siguria, Komitetit për Ekonomi, Financë dhe Statistikë dhe Komitetit të Stabilizim Asociimit. Në raportet përfundimtare të nënkomiteteve nuk është lënë shënim përkatës për ATP, nëse duhet të përmbushë ndonjë detyrë apo rekomandim.

5. *Të nxisë vijimin e ushtrimit të veprimtarisë së "Komisionit Ndërinstitucional për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e fondit të tokës për kompensimin e pronave".*

Agjencia e Trajtimit të Pronave, si anëtare e grupit të punës të ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.88/2020, për "Marrjen e masave individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 07.05.2020 "Beshiri kundër Shqipërisë dhe 11 kërkesa të tjera propozoj të shtrohej për diskutim Fondi i Tokës Bujqësore. Fondi fizik është pjesë thelbësore e ushtrimit të veprimtarisë së ATP, për kompensim fizik të pronarëve që kanë një vendim përfundimtar dhe janë vlerësuar në zbatim të ligjit nr.133/2015. Gjykata Evropiane në vendimin Beshiri, ka orientuar kompensimin fizik të pronarëve, si një mundësi e mirë për shtetin shqiptar për të ulur sadopak faturën financiare të gjithë procesit. Në mënyrë të vazhdueshme nga ATP është raportuar pranë Këshillit të Evropës, në lidhje me fondin fizik, i cili do të shërbejë për kompensim fizik në zbatim të ligjit 133/2015.

Në lidhje me këtë problematikë Grupi i Punës vlerësoi dhe ka dërguar një material pranë Kryeministrit, me qëllim riaktivizimin e Komisionit Ndërinstitucional për Identifikimin e Pronës Shtetërore, që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë e fondit të tokës për kompensimin, sipas përcaktimeve në VKM nr.901/2016. Riaktivizimi i Komitetit Ndërinstitucional do të ishte një hap pozitiv në dobi të procesit të kompensimit, pasi do të bënte të mundur identifikimin e pronave të lira nëpër Bashki dhe vënien në dispozicion të tyre ATP-së me qëllim realizimin e procesit të kompensimit.

ATP po bën përpjekjet maksimale që Fondi i Tokës të shtrihet në mënyrë sa më të balancuar në gjithë territorin e vendit, dhe të mos ngelet i kufizuar në katër qarqe, duke krijuar vështirësi për kompensimin fizik, duke qenë që rritet mundësia e kompensimit fizik në tokë shumë larg vendbanimit

të pronarëve. Kjo do të harmonizonte dhe mbajtjen e peshës së këtij procesi, në mënyrë proporcionale nga disa Bashki.

6. *Të trajtojë me përparësi kompensimin fizik të subjekteve, duke respektuar kriteret e legjislationit për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, në zonat ku zbatohen proceset kalimtare të pronësisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e procesve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".*

ATP-ja po ndërmerr hapa konkret për të pasuruar fondin fizik të tokës që do të shërbejë për kompensimin fizik të pronarëve. Nga ana ASHK dhe ATP po vijohet të identifikohet pronat e lira që do ti shërbejë këtij procesi.

7. *Të forcojë bashkëpunimin dhe bashkërendimin me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për qëllim zbatimin e ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe në veçanti për identifikimin e pronave shtetërore me qëllim pasurimin e fondit të tokës në funksion të realizimit të procesit të kompensimit fizik.*

Për këtë qëllim me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP nr.177, prot. datë 24.11.2020 është ngritur një grup pune për "Përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës ndërmjet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) për proceset kalimtare të pronësisë". Në këtë kuadër grupi ka përgatitur një draft paraprak në zbatim të pikës 3, të nenit 57, të ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", i cili po diskutohet ndërmjet institucioneve ASHK dhe ATP.

8. *T'i adresojë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, sa herë ta vlerësojë të arsyeshme, problematikat e hasura nga ky institucion, që në ushtrim të funksionit të kontrollit parlamentar të nxisë Këshillin e Ministrave, dhe Ministrinë e Drejtësisë për ndërmarrjen e nismave në zgjidhjen e tyre.*

Me propozim të Ministrisë së Drejtësisë dhe grupit të punës të miratuar me Urdhër Kryeministri Nr.88/2020, për "Marrjen e masave individuale dhe të përgjithshme për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, datë 07.05.2020 "Beshiri kundër Shqipërisë dhe 11 kërkesa të tjera, u miratua VKM 1114 datë 24.12.2020 për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 223/2016 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave".

